



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 362/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përbarimore të kreditorit ““LEVEL”, SH.P.K., me NUI: 810745565, me seli në Prishtinë rruga “Ahmet Krasniqi”, nr. 162, kundër debitorit “Komuna e Prishtinës”, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.1106/23 të datës 19.09.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Komuna e Prishtinës”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1106/23 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1106/23 të datës 19.09.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Komuna e Prishtinës”, me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 4/22, i lejuar me datë 04.02.2022, nga Përbaruesi Privat Blerim (Gezim) Baloku dhe Urdhri Përbarimor P.nr. 4/22, i lejuar me datë 04.02.2022, nga Përbaruesi Privat Blerim (Gezim) Baloku mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vertëtimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, me

propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1106/23 të datës 19.09.2023

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “LEVEL”, SH.P.K., ka paraqitur propozim për përmbarim P.nr. 4/22, i lejuar me datë 04.02.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; –Faturës Nr.089 të datës 09.11.2020, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditëve t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 955.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale deri në shumën e borxhit si dhe duke bërë bartjen e mjeteve nga llogaria e debitorit në atë të kreditorit, inventarizimi, sekuestrimi i pasurisë së debitorit dhe më pas të bëhet shitja e tyre me qëllim të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin e lejuar për përmbarim me arsyetimin se është i pabazuar, i palejuar dhe i pa qëndrueshëm, për faktin se i njëjti nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe se prova e cila i është bashkangjitur nuk është dokument i besueshëm dhe si e tillë nuk përmban titull ekzekutiv siç parashihet me nenin 29 të LPP-së, andaj dhe në bazë të kësaj nuk mund të lëshohet urdhri për përmbarim për faktin se e njëjta nuk është e pranuar dhe e nënshkruar nga persona të autorizuar. Më tutje ka shtuar se kreditori ka dështuar që të bashkangjes provat e nevojshme mbi të cilat e bazon këtë propozim për përmbarim dhe me këtë rast ka bashkangjitur vetëm faturën kopje e cila nuk i plotëson kushtet esenciale për faturë të paraparë me nenin 29 të LPP-së, si e tillë nuk mund të jetë objekt përmbarimi, pasi që e njëjta duhet të jetë e nënshkruar nga të dyja palët. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr.4/22 i datës 04.02.2022, i Përmbaruesit

Privat Blerim (Gëzim) Baloku, dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore në shumë prej 208.00 €.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapsim.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është e përshtatshme për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përbarimor nga përbaruesi privat, duke u bazuar në dokument të besueshëm – Faturën Nr.089 të datës 09.11.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Dhe rrjedhimisht në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që është dorëzuar në origjinal, mban vulën e pranimit të debitorit, si dhe nuk është kontestuar nga debitori.

Dhe duke u bazuar në të lartcekurat, shkalla e parë lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Tutje dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura me nr. Nr.089 të datës 09.11.2020, e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar

ekzekutive në mënyrë që procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç' rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 362/24 me datë 16.04.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti